Paneli këshillëdhënës për të drejtat e njeriut

Building D, UNMIK HQ, Prishtinë, Kosovë E-mail: hrap-unmik@un.org | Tel: +381 (0)38 504 604, Ext. 5182

VENDIM

Data e miratimit: 31 mars 2010

Lënda nr. 04/07

Kadri BALAJ (në emër të Mon BALAJT), Shaban Xheladini (në emër të Arben XHELADINIT), Zenel ZENELI dhe Mustafa NERJOVAJ

kundër

UNMIK-ut

Paneli këshillëdhënës për të drejta të njeriut më 31 mars 2010,
Me pjesëmarrjen e anëtarëve vijues:

z. Marek NOWICKI, kryesues
z. Paul LEMMENS
z. Christine CHINKIN

Të ndihmuar nga:
z. Nedim OSMANAGIQ, ushtrues detyre i zyrtarit ekzekutiv

Pasi mori parasysh ankesën e lartpërmendur, të parashtruar në pajtim me nenin 2.1 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12 mbi themelimin e Panelit këshillëdhënës për të drejta të njeriut, të datës 23 mars 2006.

Pasi shqyrtimit, duke përfshirë edhe shqyrtimin përmes mjeteve elektronike, në pajtim me Rregullën 13 § 2 të Rregullores së tij të punës.

Vendos si në vijim:

I. FAKTET

1. Më 10 shkurt 2007, u organizua një protestë në Prishtinë nga Vetëvendosja, lëvizje kjo që kundërshton administratën e Kombeve të Bashkuara në Kosovë dhe bën fushatë për pavarësinë e Kosovës. Njësitë policore të formuara nga UNMIK-u (FPU) që vijnë nga vende të ndryshme, duke përfshirë Rumaninë, u dërguan për t'i mbrojtur ndërtesat qeveritare dhe për të mbajtur turmën nën kontroll nëse do të ishte e nevojshme.

2. Kur protestuesit iu afruan ndërtesave qeveritare, ata hodhën gjësende në drejtim të pjesëtarëve të policisë dhe u përpoqën t'i kalojnë barrikadat. Policia hodhi gaz lotsjellës dhe ndërmori veprime të rrepta. Në këtë rast ka pasur lëndime si të policisë, ashtu edhe të protestuesve. Në një moment të caktuar disa policë gjuajtën me plumba gome, të cilët vranë Mon Balajn, djalin e ankuesit të parë, dhe Arben Xheladinin, djalin e ankuesit të dytë, si dhe plagosen të tjerët, ku disa prej tyre u plagosën mjaft rëndë, duke përfshirë Zenel Zenelin dhe Mustafa Nerjovajn – ankuesin e tretë, përkatësisht të katërtin.

3. Menjëherë pas protestës, u themelua një ekip veprues për të hetuar rrethanat e protestës dhe dhunën që ndodhi. PSSP-ja emëroi një prokuror special, i cili dorëzoi dy raporte, ku njëri mbante datën 16 prill 2007, ndërsa tjetri – 29 qershor 2007.

4. Raporti i 16 prillit 2007 erdhi në përfundim se vdekja e Mon Balajt dhe e Arben Xheladinit ka qenë e panevojshme dhe ka mundur të shmanget, dhe dukej se nuk kishte arsyetim për të shtënat në kokën e Mon Balajt dhe të Arben Xheladinit, apo në gjoksin e Zenel Zenelit. Po kështu, në raport u nxor përfundimi se të shtënat fatale dhe ato që gati sa nuk shkaktuan vdekjen me plumba gome kishin ardhur nga një apo dy pjesëtarë rumunë të FPU-së. Mirëpo, provat nuk kanë dhënë ndonjë bazë për të ditur se kush ka shtënë me plumbat vdekjeprurës apo me ata që kanë shkaktuar plagë. Rrjedhimisht, në atë kohë fillimi zyrtar i procedurave penale nuk është bërë. Prokurori special i rekomandoi UNMIK-ut, Kombeve të Bashkuara dhe Qeverisë së Rumanisë që të marrin parasysh fillimin e procedurave të duhura për kompensimin e anëtarëve të familjeve të të vrarëve dhe të të plagosurve rëndë.

5. Raporti i datës 29 qershor 2007 përmbante shqyrtimin e ligjit mbizotërues dhe një vlerësim e kritikë të praktikave dhe procedurave të zbatuara nga policia e UNMIK-ut në planifikimin dhe zbatimin e funksioneve policore para protestës së datës 10 shkurt dhe pas saj, veçanërisht lidhur me vendimin e asaj dite për përdorimin e plumbave të gomës kundër turmës. Në raport vihet në përfundim se ka pasur mangësi të ndryshme lidhur me kornizën ligjore dhe planifikimin, operacionin dhe me procesin e vendimmarrjes.

6. Familjet e viktimave i kanë parashtruar kërkesa për kompensim Bordit të UNMIK-ut për shqyrtimin e ankesave. Në bazë të informatave të dhëna nga UNMIK-u, më 27 dhjetor 2007 rekomandimet për kompensim i janë përcjellë Bordit për shqyrtimin e ankesave në selinë kryesore (Nju Jork) për shqyrtim të mëtutjeshëm.

7. Në bazë të një shkrese të UNMIK-ut të lëshuar për media më 10 shkurt 2010, në verë të vitit 2009 PSSP-ja u takua me familjen e Mon Balajt dhe të Arben Xheladinit dhe u kërkoi falje atyre në emër të OKB-së për ngjarjet e 10 shkurtit 2007. Në bazë të shkresës së njëjtë, kah

fundi i vitit 2009, Procesi për kërkesat e palëve të treta rezultoi me ofrimin zyrtar nga OKB-ja të kompensimit për secilën viktimë. Në momentin e miratimit të këtij vendimi, duket se familjarët janë ende duke shqyrtuar nëse do të marrin apo jo kompensimin e ofruar.

II. ANKESAT

8. Ankuesit pohojnë se vrasja e Mon Balajt dhe Arben Xheladinit dhe plagosja e rëndë e Zenel Zenelit dhe Mustafa Nerjovajt përbëjnë shkelje të së drejtës në jetë, të ndalimit të torturës dhe të së drejtës për grumbullim të qetë. Ata gjithashtu pohojnë se nuk ka pasur hetim të efektshëm të incidentit, që ka rezultuar me shkelje të aspekteve procedurale të së drejtës në jetë dhe të ndalesës së torturës. Në fund, ata pohojnë se duke mos qenë në gjendje që kërkesëpadinë kundër UNMIK-ut t'a dërgojnë në gjyq apo në cilindo organ tjetër të aftë për të gjetur zgjidhje, e drejta e tyre në gjykim të drejtë dhe në mjet të efektshëm ligjor është shkelur.

9. Ata thirren në instrumentet vijuese për të drejtat e njeriut:

- Deklaratën Universale për të Drejta të Njeriut, veçanërisht në nenet 3, 5, 8, 10 dhe 20;
- Konventën Evropiane për të Drejta të Njeriut (KEDNj), veçanërisht në nenet 2, 3, 6, 11 dhe 13;
- Konventën Ndërkombëtare për të Drejta Civile dhe Politike, veçanërisht në nenet 2, 6, 7 dhe 21;
- Konventën kundër Torturës dhe Trajtimit tjetër të Vrazhdë, Jonjerëzor apo Poshtërues, si dhe Dënimit, veçanërisht në nenet 2, 10, 12, 13, 14 dhe 16.

III. PROCEDURAT PARA PANELIT

10. Ankesa është parashtruar më 11 tetor 2007 dhe është regjistruar në të njëjtën datë. Gjatë procedurave para Panelit, ankuesit janë përfaqësuar nga z. Halim Sylejmani, avokat nga Kosova, dhe nga zotërinjtë Paul Troop dhe Jude Bunting, avokatë nga Londra.

11. Paneli ia komunikoi rastin PSSP-së më 7 shkurt 2008, duke ia dhënë atij mundësinë të jep komente në emër të UNMIK-ut lidhur me pranueshmërinë dhe bazueshmërinë e tij në pajtim me nenin 11.3 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12 dhe me rregullën 30 të Rregullores së punës të Panelit. PSSP-ja nuk ka shfrytëzuar këtë mundësi.

12. Përmes vendimit të datës 6 qershor 2008, Paneli shpalli ankesën si të pranueshme.

13. Më 16 shtator 2008, PSSP ngriti një vërejtje për pranueshmërinë e ankesës, duke u bazuar në mosshterjen e mundësive në dispozicion. Vërejtja iu është komunikuar ankuesve, të cilët dërguan përgjigjen e tyre më 6 tetor 2008.

14. Gjatë sesionit të tij të tetorit, Paneli vendosi të caktojë seancën publike në janar të vitit 2009. Paneli gjithashtu vendosi t'ia bashkëngjis çështjen e pranueshmërisë të ngritur nga

PSSP-ja procesit të shqyrtimit të bazueshmërisë. Po ashtu, Paneli ftojë PSSP-në që të trajtojë bazueshmërinë e ankesës.

15. Më 15 dhjetor 2008, PSSP-ja dha komente në parashtresat e ankuesve lidhur me vërejtjen ndaj pranueshmërisë së ankesës. Këto komente iu komunikuan ankuesve.

16. Për shkak të pamundësisë së ankuesve për të marrë pjesë në seancën e janarit 2009, në ndërkohë, data e seancës publike është ricaktuar për 19 mars 2009. Palët janë ftuar që të plotësojë parashtresat e tyre me shkrim.

17. Më 23 shkurt 2009, ankuesit dërguan parashtresat, ku ata dhanë komente të tjera për pranueshmërinë e ankesës dhe për bazueshmërinë e saj. Ata gjithashtu dërguan një numër dokumentesh. Këto parashtresa dhe dokumente i janë komunikuar PSSP-së.

18. Më 3 mars 2009, Paneli u dërgoi palëve një numër pyetjesh, duke i ftuar që t'i trajtojnë ato gjatë seancës.

19. Më 11 mars 2009, PSSP-ja dërgoi komentet e tij të tjera, duke përfshirë përgjigjet në pyetjet e ngritura nga Paneli në letrën e tij të datës 3 mars 2009, si dhe përgjigjen në parashtresat e ankuesve të datës 23 shkurt 2009. PSSP-ja po ashtu dërgoi një numër dokumentesh.

20. Pak para se të mbahej seanca publike, UNMIK-u informon Panelin se nuk do të mund të garantonte sigurinë para seancës dhe pas saj. Në bazë të kësaj informate, më 18 mars 2009 Paneli vendosi që seanca të mos jetë publike. [1]

21. Seanca u mbajt më 19 mars 2009[2]. Në të morën pjesë përfaqësuesit e palëve si në vijim:

-Në emër të UNMIK-ut:
- z. Ernst Tschoepke, ushtrues detyre i drejtorit të Zyrës së Këshilltarit ligjor,
- z. Carl Campeau, zyrtar ligjor në Zyrën e Këshilltarit ligjor.

- Në emër të ankuesve:
- z. Paul Troop, avokat, Took Chambers, Londër,
- z. Jude Bunting, avokat, Took Chambers, Londër,
- z. Halim Sylejmani, avokat, Prishtinë,
- z. Alexandra Channer, ndihmëse e z. Sylejmanit, Prishtinë.

Ankuesit, Kadri Balaj, Shaban Xheladini, Zenel Zeneli dhe Mustafa Nerjovaj gjithashtu kanë qenë të pranishëm.

22. Gjatë seancës, ankuesit dorëzuan parashtresat lidhur me të drejtën për seancë publike. Ata deklaruan se nuk do të vazhdojnë të marrin pjesë në seancë të mbyllur, dhe kërkuan shtyrjen e seancës, në mënyrë që e njëjta të mbahet para publikut. Paneli, pasi vërejti se përfaqësuesi i UNMIK-ut nuk e kundërshtoi shtyrjen e seancës, vendosi që ta shtyjë

[1] Shih komunikatën për shtyp të Panelit të datës 18 mars 2009.
[2] Shih komunikatën për shtyp të Panelit të datës 19 mars 2009.

seancën për datën 4 qershor 2009, kur seanca do të mbahej para publikut në një vend të përshtatshëm.

23. Paneli më pastaj është informuar nga PSSP-ja se përfaqësuesit e UNMIK-ut nuk do të marrin pjesë në seancë sipas procedurës së paraparë nga Paneli. PSSP-ja gjithashtu shpalli qëllimin e tij për të miratuar një urdhëresë administrative, përmes së cilës do të qartësohej natyra e seancave publike para Panelit. Në bazë të kësaj informate Paneli erdhi në përfundim se seanca më nuk do të kishte domethënie. Rrjedhimisht, më 12 maj 2009, vendosi që ta anuloj seancën[3].

24. Më 20 maj 2009, ankuesit dërguan parashtresa lidhur me anulimin e seancës. Ata gjithashtu kërkuan dhënien e komunikimeve mes PSSP-së dhe Panelit lidhur me këtë lëndë. Më 26 maj 2009, Paneli vendosi që vendimi i tij për anulimin e seancës të merr formën e prerë. Kërkesa për dhënien e dokumenteve i është komunikuar PSSP-së, i cili dërgoi komentet e tij më 29 maj 2009. Më 18 qershor 2009, Paneli vendosi se nuk do t'u barten komunikime shtesë ankuesve.

25. Në të njëjtën ditë (18 qershor 2009), pas anulimit të seancës, Paneli ftoj ankuesit që t'i trajtojnë me shkrim pyetjet e parashtruara nga Paneli më 3 mars 2009. Paneli gjithashtu parashtrojë disa pyetje shtesë si ankuesve, ashtu edhe PSSP-së.

26. PSSP-ja dërgoi përgjigjet e tij në pyetjet shtesë më 1 korrik 2009. Ankuesit dërguan komentet e tyre, duke përfshirë përgjigjen në komentet e PSSP-së së 11 marsit 2009. Çdo përgjigje i është komunikuar palës tjetër, të cilëve u është dhënë mundësia për të komentuar lidhur me to.

27. Ankuesit dhe PSSP-ja dërguan komentet e tjera më 11 gusht 2009.

28. Më 22 tetor 2009, duke marrë parasysh se më 17 tetor 2009 PSSP-ja nxjerri Urdhëresën administrative nr. 2009/1 për zbatimin e Rregullores së UNMIK-ut 2006/12 mbi themelimin e Panelit këshillëdhënës për të drejta të njeriut, Paneli ftojë palët që të parashtrojnë komentet lidhur me efektin e kësaj urdhërese administrative për lëndën në fjalë.

29. Ankuesit u përgjigjen më 12 nëntor 2009, duke parashtruar ankesën kundër Urdhëresës administrative nr. 2009/1. Kjo ankesë është regjistruar nga Paneli me numër 320/09. Paneli ia komunikoi këtë ankesë të re PSSP-së, i cili i dërgoi komentet e tij lidhur me pranueshmërinë e asaj ankese më 14 dhjetor 2009.

30. Më 18 janar 2010, Paneli pranoi përgjigjen e PSSP-së në letrën e tij dërguar më 22 tetor 2009. Kjo përgjigje mbante datën 30 tetor 2009.

31. Më 12 janar 2010, Paneli shpalli ankesën me numër të lëndës 320/09 si të papranueshme.

---

[3] Shih komunikatën për shtyp të datës 12 maj 2009.

IV. KORNIZA RELEVANTE NORMATIVE

32. Derisa kjo ankesë priste zgjidhjen para Panelit, duke pritur mendimin për bazueshmërinë e saj, më 17 tetor 2009 PSSP-ja nxjerri Urdhëresën administrative nr. 2009/1 për zbatimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12 mbi themelimin e Panelit këshillëdhënës për të drejta të njeriut. Nenet 2.1, 2.2 dhe 2.3 të kësaj Urdhërese administrative janë si në vijim:

> "2.1. Në cilëndo fazë të procedurave të ankesave për shkeljen e të drejtave njerëzore, Paneli këshillëdhënës shqyrton çështjet e pranueshmërisë së ankesës para se të shqyrtojë bazueshmërinë e saj.
>
> 2.2. Çfarëdo ankese që është pjesë e Procesit të OKB-së për kërkesat e palëve të treta apo që mund të bëhet në të ardhmen pjesë e një procesi të tillë ose që mund të bëhet pjesë e procedurave sipas nenit 7 të Rregullores së ndryshuar të UNMIK-ut nr. 2000/47 për statusin, privilegjet dhe imunitetin e KFOR-it, e UNMIK-ut dhe të punonjësve të tyre në Kosovë, të datës 18 gusht 2000, konsiderohet e papranueshme për arsye se Procesi i OKB-së për kërkesat e palëve të treta dhe procedura sipas nenit 7 të Rregullores së UNMIK-ut janë mundësi në dispozicion në pajtim me nenin 3.1 të Rregullores nr. 2006/12.
>
> 2.3 Komentet për bazueshmërinë e shkeljeve të pohuara të të drejtave të njeriut dorëzohen vetëm pasi që Paneli këshillëdhënës të ketë kryer shqyrtimin e tij dhe të ketë marrë vendimin për pranueshmërinë e asaj ankese. Nëse çështjet e pranueshmërisë së ankesës trajtohen në cilëndo kohë pasi që Paneli këshillëdhënës të ketë marrë vendimin për pranueshmërinë e ankesës dhe të ketë filluar shqyrtimin e tij për bazueshmërinë e saj, Paneli këshillëdhënës pezullon shqyrtimin e tij për bazueshmëri deri në kohën kur pranueshmëria e ankesës të jetë rivlerësuar plotësisht dhe të jetë marrë vendimi i ri."

33. Neni 5 i Urdhëresës administrative nr. 2009/1 parasheh që asnjë ankesë e parashtruar në Panel nuk do të jetë e pranueshme "nëse pranohet nga Sekretaria e Panelit këshillëdhënës më vonë se më 31 mars 2010."

34. Neni 6 parasheh që Urdhëresa administrative nr. 2009/1 hyn në fuqi më 17 tetor 2009, që është data e nxjerrjes së saj, dhe "se vlen për të gjitha ankesat e parashtruara në Panelin këshillëdhënës, duke përfshirë edhe ato që aktualisht presin zgjidhje në Panelin këshillëdhënës".

35. Procesi i OKB-së për kërkesat e palëve të treta, i cekur në nenin 2.2 përbën objektin e Rezolutës 52/247 të Asamblesë së Përgjithshme, të datës 17 korrik 1998, për "Përgjegjësinë e palës së tretë: kufizimet kohore dhe financiare" (A/RES/52/247). Dispozitat relevante të kësaj Rezolute parashohin si në vijim:

> "5. *Vendosë* se kufizimet kohore dhe financiare të parapara në paragrafin 8 deri në 11 më poshtë vlejnë për kërkesat e palëve të treta ndaj Organizatës lidhur me

lëndimet, sëmundjen apo vdekjen e personit, si dhe me humbjen apo dëmtimin e pronës (duke përfshirë shfrytëzimin pa pëlqim të objekteve) që rezultojnë apo që i atribuohen aktiviteteve të pjesëtarëve të operacioneve paqeruajtëse gjatë zbatimit të detyrave të tyre zyrtare, ashtu siç është përshkruar në paragrafin 13 të raportit të Sekretarit të Përgjithshëm (A/51/903);

6. *Miraton* pikëpamjen e Sekretarit të Përgjithshëm se nuk kërkohet përgjegjësia lidhur me kërkesat e palëve të treta që rezultojnë nga aktivitetet e pjesëtarëve të operacioneve paqeruajtëse ose që u atribuohen atyre, të cilat rrjedhin nga 'nevoja operacionale', ashtu siç është përshkruar në paragrafin 14 të raportit të parë të Sekretarit të Përgjithshëm për përgjegjësinë e palës së tretë (A/51/389);

7. *Gjithashtu miraton* pikëpamjet e Sekretarit të Përgjithshëm, të pasqyruara në paragrafin 14 të raportit të tij (A/51/903), lidhur me kërkesat e palëve të treta që rezultojnë nga shpërfillja e skajshme apo keqsjellja e qëllimshme e punonjësve, të ofruar nga shtetet kontribouese të trupave për operacionet paqeruajtëse, dhe përmes raporteve relevante të mbarëvajtjes së punës, kërkon nga ai që të raporton për zbatimin e tyre;

8. *Vendosë* , në rastet kur kërkohet përgjegjësia e Organizatës lidhur me kërkesat e palëve të treta ndaj Organizatës që rezultojnë nga operacionet paqeruajtëse, se Organizata nuk do të paguajë kompensim lidhur me ato kërkesa të dorëzuara pas gjashtë muajsh nga koha e dëmtimit, lëndimit apo humbjes së shkaktuar, ose nga koha kur i njëjti është zbuluar nga kërkuesi, dhe, në cilido rast, pas një viti nga përfundimi i mandatit të operacionit paqeruajtës, me kusht që në rrethana të jashtëzakonshme, siç janë përshkruar në paragrafin 20 të raportit të Sekretarit të Përgjithshëm, Sekretari i Përgjithshëm mund të pranojë për shqyrtim kërkesën e bërë në një datë të mëvonshme;

9. *Gjithashtu vendosë*, lidhur me kërkesat e palëve të treta kundër Organizatës për lëndim, për sëmundje apo për vdekje të personit që rezulton nga operacionet paqeruajtëse, që:

(*a*) Llojet e kompensueshme të lëndimit apo të humbjes do të kufizohen në humbjen ekonomike, siç janë shpenzimet mjekësore apo të rehabilitimit, fitimet e humbura, përkrahjen e humbur financiare, shpenzimet e transportit të ndërlidhura me lëndimin, sëmundjen apo kujdesin mjekësor, si dhe shpenzimet juridike e ato të varrimit;

(*b*) Kombet e Bashkuara nuk paguajnë kompensim për humbjet joekonomike, siç është dhimbja dhe vuajtjet apo dëmtimet ndëshkuese a morale;

(*c*) Kombet e Bashkuara nuk paguajnë kompensim për shërbime të ndihmës shtëpiake apo për dëmtimet e tjera të tilla, të cilat vetëm sipas mendimit të Sekretarit të Përgjithshëm, janë të pamundura për t'u vërtetuar apo nuk janë drejtpërdrejtë të lidhura me vet lëndimin ose humbjen;

(*d*) Shuma e kompensimit të pagueshëm për lëndim, sëmundje apo vdekje të cilitdo individ, duke përfshirë edhe shumën për llojet e humbjes dhe shpenzimet e përshkruara në nënparagrafin (*a*) më lartë, nuk kalon shumën maksimale prej 50 000 dollarëve amerikanë, me kusht që brenda këtij kufizimi, shuma e saktë të përcaktohet duke iu referuar standardeve vendore të kompensimit;

(*e*) Në rrethana të jashtëzakonshme, Sekretari i Përgjithshëm mund t'i rekomandojë Asamblesë së Përgjithshme që kufizimi prej 50 000 dollarëve i paraparë në nënparagrafin (*d*) më lartë të rritet për ndonjë rast të veçantë nëse Sekretari i Përgjithshëm, pas zbatimit të hetimeve të kërkuara, përcakton se ka arsye të forta për tejkalimin e kësaj shume;

10. *Po kështu, vendosë* për kërkesat e palëve të treta ndaj Organizatës për humbjen a dëmtimin e pronës që vjen si rrjedhojë e operacioneve paqeruajtëse që:

(*a*) Kompensimi për shfrytëzimin e objekteve pa pëlqim do të: (i) llogaritet në bazë të vlerës së drejtë të qirasë nga ekipi i Kombeve të Bashkuara për vlerësim teknik që dërgohet para fillimit të misionit, e cila vlerë përcaktohet në bazë të çmimeve vendore në tregun e qirave që kanë ekzistuar para vendosjes së operacionit paqeruajtës apo (ii) nuk tejkalon shumën maksimale të pagueshme për metër katror ose për hektar, të përcaktuar nga ekipi i Kombeve të Bashkuara për vlerësim teknik që dërgohet para fillimit të misionit në bazë të informatave përkatëse të disponueshme; Sekretari i përgjithshëm do të vendosë për metodën e duhur të llogaritjes së kompensimit të pagueshëm për shfrytëzimin pa pëlqim të objekteve pas përfundimit të vlerësimit nga ekipi i Kombeve të Bashkuara për vlerësim teknik;

(*b*) Kompensimi për humbje apo dëmtim ndaj objekteve do të: (i) llogaritet në bazë të numrit të muajve të shumëzuar me qiranë mujore apo në bazë të përqindjes fikse të shumës së qirasë që është e pagueshme për periudhën e qëndrimit të Kombeve të Bashkuara ose (ii) do të caktohet sipas përqindjes fikse të shpenzimeve të riparimit; Sekretari i Përgjithshëm do të vendosë për metodën e duhur për llogaritjen e kompensimit të pagueshëm për humbjen apo dëmtimin e pronave pas përfundimit të vlerësimit nga ekipi i Kombeve të Bashkuara për vlerësim teknik që dërgohet para fillimit të misionit;

(*c*) Kombet e Bashkuara nuk paguajnë kompensim për humbjet ose dëmtimet, të cilat vetëm sipas mendimit të Sekretarit të Përgjithshëm janë të pamundura të vërtetohen apo nuk janë drejtpërdrejtë të lidhura me humbjen apo dëmtimin e objekteve;

11. *Vendosë* që:

(*a*) Kompensimi për humbjen apo dëmtimin ndaj pronës personale të palëve të treta që rrjedhin nga aktivitetet e operacionit apo që janë në lidhje me zbatimin e detyrave zyrtare nga anëtarët e tij do të bëhet për shpenzimet e arsyeshme të riparimit dhe të zëvendësimit;

(*b*) Kombet e Bashkuara nuk paguajnë kompensim për humbje apo dëmtim që vetëm sipas mendimit të Sekretarit të Përgjithshëm është i pamundur të vërtetohet apo nuk është drejtpërdrejtë i lidhur me humbjen a dëmtimin e pronës personale;

12. *Kërkon* nga Sekretari i Përgjithshëm të ndërmerr masat e nevojshme për zbatimin e kësaj Rezolute përkitazi me marrëveshjet rreth statusit të forcave në përputhje me paragrafin 40 të këtij raporti (A/51/903);

13. *Gjithashtu kërkon* nga Sekretari i Përgjithshëm të sigurohet që përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësive të këshillave vendore të shqyrtimit të përfshijnë edhe kufizimet kohore dhe financiare lidhur me përgjegjësinë e Organizatës, ashtu siç është paraparë në paragrafët 8 deri në 11 më lartë, dhe që këto këshilla të

mbështeten në ato kufizime kohore dhe financiare si bazë për juridiksionin dhe rekomandimet e tyre për kompensimin e kërkesave të palëve të treta kundër Organizatës, të cilat rezultojnë nga operacionet e saj paqeruajtëse.”

36. Neni 7 i Rregullores së UNMIK-ut nr. 2000/47 për statusin, privilegjet dhe imunitetin e KFOR-it, UNMIK-ut dhe të punonjësve të tyre në Kosovë, të datës 18 gusht 2000, i cekur në nenin 2.2 të Urdhëresës administrative nr. 2009/1, thotë:

> “Kërkesat e palëve të treta për humbje apo dëmtim të pronës, si dhe për lëndim, sëmundje apo vdekje të personit që rrjedhin apo që i atribuohen drejtpërsëdrejti KFOR-it, UNMIK-ut apo punonjësve të tyre, dhe të cilat nuk rrjedhin nga “nevoja operacionale” të cilësdo prej këtyre pranive, rregullohen nga komisionet për kërkesa, të themeluara nga KFOR-i dhe UNMIK-u, sipas mënyrës që do të përcaktohet.”

V. LIGJI

A. Nëse ankesa konsiderohet e papranueshme

i. Argumentet e palëve

37. Pasi është ftuar nga Paneli për të dhënë komente lidhur me ndikimin e nenit 2 të Urdhëresës administrative nr. 2009/1 në rastin konkret, UNMIK-u thekson se lënda e ankuesve i është nënshtruar “Procesit të OKB-së për kërkesat e palëve të treta sipas Rregullores së UNMIK-ut nr. 2000/47”. UNMIK-u po ashtu argumenton se neni 2.2 i Urdhëresës administrative nr. 2009/1 vlen dhe se rrjedhimisht ankesa konsiderohet e papranueshme. Ai pret nga Paneli që të veprojë në përputhje me Urdhëresën administrative dhe të merr vendimin që plotësisht zbaton këtë legjislacion.

38. Ankuesit u përgjigjen duke parashtruar një ankesë të re, ku u pohua se Urdhëresa administrative 2009/1 shkel nenin 6 § 1 të KEDNj-së. Në veçanti, ata argumentuan se Urdhëresa administrative ka qëllim të ketë efekt të rihapjes së çështjes së pranueshmërisë, duke e përcaktuar çështjen e pranueshmërisë dhe duke parandaluar panelin nga shqyrtimi i bazueshmëpriusë së ankesës, duke parandaluar procedurat kundërshtuese dhe duke minuar pavarësinë dhe paanësinë e Panelit. Kjo ankesë është regjistruar me nr. 320/09.

ii. Të gjeturat e Panelit

A. Nëse ankesa konsiderohet e papranueshme

39. Para se të vazhdohet me marrjen parasysh të bazueshmërisë së ankesës, Paneli fillimisht duhet të shqyrtojë vërejtjen e re të UNMIK-ut për pranueshmëri, në pajtim me nenin 2.3 të Urdhëresës administrative të UNMIK-ut nr. 2009/1.

Çështja e ligjshmërisë së Urdhëresës administrative nr. 2009/1

40. Siç konsideroi Paneli në vendimin e tij të datës 12 shkurt 2010 lidhur me ankesën e ankuesve, të regjistruar me nr. 320/09, është në bindjen e lirë të PSSP-së që të përcaktojë skemën rregulluese të sistemit të ankesave të parashtruara në Panel, ku Paneli nuk ka juridiksion për të shqyrtuar përputhshmërinë e bazës ligjore të funksionimit të tij me standardet e të drejtave të njeriut.

41. Paneli rithekson se madje edhe nëse mund të vihet seriozisht në pyetje nëse PSSP-ja ka kompetenca për të ndryshuar disa nga parimet bazë të Rregullores 2006/12 përmes një urdhërese administrative për "zbatimin e saj", për qëllime të juridiksionit të Panelit, nuk ka dallim nëse modifikimet bëhen përmes rregullores apo urdhëresës administrative. Mbetet fakti se dispozitat e Urdhëresës administrative nr. 2009/1 të UNMIK-ut përbëjnë pjesën e bazës së funksionimit të Panelit.

42. Me keqardhje, Paneli duhet të vijë në përfundim se nuk ka juridiksion të merret me argumentet e ngritura nga ankuesit lidhur me paligjshmërinë e Urdhëresës administrative nr. 2009/1.

43. Rrjedhimisht, nga Paneli kërkohet të shqyrtojë thelbin e vërejtjes së ngritur nga UNMIK-u.

Vërejtja e parashtruar nga UNMIK-u

44. Neni 2.2 i Urdhëresës administrative nr. 2009/1 parasheh që çfarëdo ankese "që është pjesë e Procesit të Kombeve të Bashkuara për kërkesat e palëve të treta apo që mund të bëhet pjesë e një procesi të tillë në të ardhmen" që është bërë e aplikueshme për UNMIK-un në bazë të nenit 7 të Rregullores nr. 2000/47 "konsiderohet si e papranueshme", për arsye se ky proces llogaritet si mundësi në dispozicion në kuptim të nenit 3.1 të Rregullores nr. 2006/12.

45. Sipas nenit 3.1 të Rregullores nr. 2006/12 ankuesi duhet të ketë qasje të rregullt në mundësitë në dispozicion dhe që janë të mjaftueshme për të kërkuar zgjidhje lidhur me shkeljet e pohura. Ekzistimi i mundësive në fjalë duhet të jetë i sigurt në mënyrë të mjaftueshme jo vetëm në teori, por edhe në praktikë, dështimi i të cilave do të rezulton me mungesë të qasshmërisë dhe efektshmërisë së kërkuar (krahaso lidhur me kërkesën për shterjen të mjeteve për zgjidhje të rastit sipas nenit 35 § 1 të KEDNj-së, Gjykata Evropiane për të Drejta të Njeriut (GjEDNj) (Dhoma kryesore) *Demopoulos dhe të tjerët kundër Turqisë*, nr. 46113/99 dhe tjetër, vendimi i datës 1 mars 2010, § 70, duke cituar nga KEDNj, *Akdivar dhe të tjerët kundër Turqisë*, aktgjykimi i datës 16 shtator 1996, *Raportet e aktgjykimeve dhe vendimeve*, 1996-IV, f. 1210, § 66). Do të ishte normale që Paneli të kënaqet se Procesi i OKB-së për kërkesat e palëve të treta, si çdo mundësi tjetër që mund të avancohet nga UNMIK-u "të ishte i efektshëm dhe i disponueshëm si në teori, ashtu edhe në praktikë në kohën përkatëse, gjegjësisht, se ka qenë i qasshëm, se ka krijuar zgjidhje lidhur me ankesat e ankuesve dhe se ka ofruar perspektivë të arsyeshme për sukses" (krahaso KEDNj, *Akdivar dhe të tjerët kundër Turqisë*, aktgjykimi i cituar më lartë, p. 1211, § 68).

46. Neni 2.2 i Urdhëresës administrative nr. 2009/1 ia heq këtë juridiksion Panelit për të konsideruar Procesin e OKB-së për kërkesat e palëve të treta si një mundësi të qasshme dhe efikase.

47. Megjithatë, kjo nuk nënkupton se vetëm fakti i ngritjes së vërejtjes nga UNMIK-u, duke u bazuar në nenin 2.2 të Urdhëresës administrative nr. 2009/1 në mënyrë të paevitueshme çon në përfundim që ankesa të konsiderohet e papranueshme. Paneli konsideron që kur ngritet një vërejtje e tillë, duhet të vërtetojë nëse objekti i ankesës para Panelit është i natyrës së tillë që me arsye mund të rezultojë me kërkesë që mund të trajtohet në kuadër të Procesit të OKB-së për kërkesat e palëve të treta. Paneli shpall ankesën e papranueshme vetëm atëherë kur bindet se kërkesa është e tillë që hyn *prima facie* në kuadër të fushëveprimit të Procesit të OKB-së për kërkesat e palëve të treta. Nga ana tjetër, nuk mund të përfshihet në shqyrtimin nëse rezultati i procesit është i aftë të ofrojë zgjidhje të mjaftueshme lidhur me ankesën para Panelit, e as nëse procesi ofron perspektivë të arsyeshme të suksesit për ankuesit.

48. Procedura e paraparë në Rezolutën 52/247 të Asamblesë së Përgjithshme dhe në nenin 7 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2000/47 ia mundëson Kombeve të Bashkuara që sipas bindjes së lirë të jep kompensim për kërkesat lidhur me lëndimin, sëmundjen apo vdekjen e personit, si dhe për humbjen apo dëmtimin e pronës, të cilat rrjedhin nga veprat e UNMIK-ut që nuk janë bërë nga nevoja operacionale. Rrjedhimisht, ankesat për shkeljen e të drejtave të njeriut që i atribuohen UNMIK-ut do të konsiderohen të papranueshme sipas nenit 2.2 të Urdhëresës administrative të UNMIK-ut nr. 2009/1 deri në masën kur të kenë rezultuar qoftë në lëndim, sëmundje a vdekje të personit apo në humbje a dëmtim të pronës. Ankesat për shkeljet e të drejtave të njeriut që nuk kanë rezultuar me dëme të natyrës së tillë në parim nuk do të jenë në kundërshtim me kushtin për shterjen e Procesit të OKB-së për kërkesat e palëve të treta.

49. Sa i përket vërejtjes së ngritur nga UNMIK-u në rastin konkret, Paneli përkujton se ankesa e parashtruar ka të bëjë me vrasjen dhe plagosjen e rëndë të katër individëve që morën pjesë në demonstrata, me efektshmërinë e hetimit penal pas demonstratës dhe dhunës, si dhe me pamundësinë që ankuesit të dërgojnë kërkesëpadinë kundër UNMIK-ut në ndonjë gjykatë apo para cilitdo organ që do të ishte në gjendje të ofronte zgjidhje.

50. Ankesat thelbësore, të shpallura si të pranueshme nga Paneli në vendimin e tij për pranueshmëri të datës 6 qershor 2008 janë kryesisht të lidhura me përdorimin e forcës nga policia e UNMIK-ut, e cila ka rezultuar me plagosje apo vdekje të personave. Paneli konsideron se këto pjesë të ankesës hyjnë *prima facie* në kuadër të fushëveprimit të Procesit të OKB-së për kërkesat e palëve të treta, dhe rrjedhimisht konsiderohen si të papranueshme.

51. Ankesat procedurale që janë shpallur si të pranueshme nga Paneli, siç janë ankesat për shkeljet e aspekteve procedurale të së drejtës në jetë dhe ndalimi i trajtimit jonjerëzor dhe poshtërues, si dhe për shkeljet e së drejtës për gjykim të drejtë dhe të së drejtës për mundësi të efektshme për trajtimin e ankesës kanë të bëjnë me veprime, lëshime apo situata që

qartazi nuk kanë rezultuar me lëndime, sëmundje apo vdekje të personit e as me humbje ose dëmtim të pronës. Si të tilla, këto pjesë të ankesës rrjedhimisht nuk janë të mbuluara nga Procesi i OKB-së për kërkesat e palëve të treta.

52. Megjithatë, Paneli konsideron se ankesat thelbësore dhe procedurale që presin zgjidhje para Panelit janë ashtu të ndërlidhura që ndarja e tyre do të ishte artificiale, duke rezultuar në trajtimin e ankesave thelbësore përmes Procesit të OKB-së për kërkesat e palëve të treta dhe në trajtimin e njëkohshëm të ankesave procedurale nga Paneli.

53. Rrjedhimisht, Paneli konsideron se e tërë ankesa është e papranueshme.

B. Efektet e vendimit që ankesa të konsiderohet e papranueshme

54. Paneli konsideron që është e dobishme të shpjegohen efektet e vendimit të tij për shpalljen e ankesës si të papranueshme.

55. Kushtet për shterjen e mundësive në dispozicion për nga natyra e tyre janë vetëm kufizime të përkohshme për pranueshmëri. Efekti i shpalljes së papranueshmërisë për shkak të mosshterjes së mundësive në dispozicion në parim është i natyrës së vonimit dhe nuk ka natyrë përfundimtare. Kjo do të thotë se ankuesi mund të parashtrojë ankesën e tij pasi që të jenë përfunduar të gjitha proceset e kërkuara. Lidhur me këtë rast, kjo pikëpamje pranohet nga UNMIK-u. Në shkresën e dërguar nga drejtori i Zyrës për çështje ligjore, të datës 30 tetor 2009, që i është bashkëngjitur letrës së PSSP-së të së njëjtës datë, thuhet se lëndët që konsiderohen si të papranueshme në bazë të nenit 2.2 të Urdhëresës administrative nr. 2009/1 "ankuesit mund t'ia riparashtrojnë (Panelit) pas kryerjes së përpunimit të ankesave të tyre përkatëse sipas (…) Procesit të OKB-së për kërkesat e palëve të treta".

56. Nëse ankuesit dëshirojnë ta shfrytëzojnë këtë mundësi, nga ata zakonisht do të kërkohet t'ia parashtrojnë Panelit një ankesë të re pasi që të jetë përfunduar Procesi i OKB-së për kërkesat e palëve të treta. Në bazë të shkresës së lartpërmendur të drejtorit të Zyrës për çështje ligjore, ankuesit do të mund të bëjnë një gjë të tillë "deri më 31 mars 2010", datë e fundit kjo për parashtrimin e ankesave Panelit, e cila është paraparë në nenin 5 të Urdhëresës administrative të UNMIK-ut nr. 2009/1.

57. Mirëpo, nëse kërkohet që ankuesit të riparashtrojnë ankesën pas përfundimit të Procesit të OKB-së për kërkesat e palëve të treta, ata pashmangshmërisht do të kalonin afatin e 31 marsit 2010 për dorëzimin e ankesave të reja. Kushti për shkuarjen përmes Procesit të OKB-së për kërkesat e palëve të treta në atë rast do ta shuante ankesën, duke mos i lënë mundësi ankuesve që t'ia riparashtrojnë atë Panelit, përkundër faktit që, siç erdhi në përfundim Paneli më 5 qershor 2009, ankesa ishte e pranueshme sipas kornizës rregulluese në fuqi në kohën kur është parashtruar. Një rezultat i tillë do të fyente nocionet bazë të drejtësisë. Në kontekstin specifik të datës së fundit, të përcaktuar përmes Urdhëresës administrative nr. 2009/1, Paneli konsideron se kjo paraqet një rregullim specifik, përmes të cilit do të ruhet mundësia që ankuesve t'iu shqyrtohet ankesa më tej nga Paneli pas përfundimit të Procesit të OKB-së për kërkesat e palëve të treta, nëse ata do të dëshironin që të vazhdojnë me shqyrtimin e rastit para Panelit.

58. Lidhur me procedurat para tribunaleve të ndryshme ndërkombëtare, Paneli thekson se në rrethana të caktuara të posaçme, aplikuesit mund të kërkojnë të fitojnë rihapjen e procedurave që janë mbyllur, në rastet kur dalin në shesh rrethanat e reja dhe kur rihapja e këtyre procedurave është në interes të drejtësisë.

59. Për shembull, është praktikë e zakonshme e Gjykatës Evropiane për të Drejta të Njeriut që t'i heq lëndët nga lista, në pajtim me nenin 37 § 1 (c) të KEDNj-së, në rastet kur për arsye objektive nuk është më e arsyeshme që të vazhdohet me shqyrtim të aplikacionit. Në raste të tilla, në bazë të nenit 37 § 2 të KEDNj-së, Gjykata mund të kthej aplikacionin në listën e saj të lëndëve, nëse konsideron se rrethanat arsyetojnë një veprim të tillë (për aplikacione, shih GjEDNj, *Aleksentseva dhe 28 të tjerë kundër Rusisë*, nr. 75025/01 dhe tjetër, vendimi i datës 23 mars 2006; GjEDNj, *Jashi kundër Gjeorgjisë*, nr. 10799/06, vendim i datës 9 dhjetor 2008).

60. Njashtu, *në rastin e testeve bërthamore*, Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë (GjND), duke marrë parasysh deklaratën e njëanshme të bërë nga shteti i paditur, në vitin 1974 vendosi se kërkesëpadia e shtetit paditës më nuk kishte objekt dhe se Gjykata rrjedhimisht nuk ishte e detyruar të merr vendim për të. Përmes të njëjtit aktgjykim, ia mundësoi shtetit paditës që të kërkojë shqyrtimin e situatës "nëse do të prekej baza e aktgjykimit të tij" (GjND, *Zelanda e Re kundër Francës*, aktgjykimi i datës 20 dhjetor 1974, *raportet e GjND-së*, 1974, f. 457, § 63). Rreth 20 vite më vonë, shteti paditës tentoi t'i rihapë procedurat. GjND-ja shpjegoi se, duke i futur fjalët e lartëcituara në aktgjykimin e saj të vitit 1974, nuk ka mundur të ketë për qëllim kufizimin e qasjes së paditësit në procedurat juridike, siç është parashtrimi i padisë së re, kërkesa për interpretim apo kërkesa për rishikim, pasi që procedurat e tilla do të ishin të hapura për të në cilindo rast. Ajo në fakt nuk ka përjashtuar procedurën e veçantë" (*Kërkesë për shqyrtimin e situatës në përputhje me paragrafin 63 të aktgjykimit të Gjykatës së datës 20 dhjetor 1974 lidhur me testet bërthamore (Zelanda e re kundër Francës), urdhri për rastin, i datës 22 shtator* 1995, raportet e GjND-së 1995, f. 288, §§ 52-53).

61. Duke marrë parasysh këto praktika, Paneli konsideron se një "procedurë e ngjashme e veçantë" duhet të jetë në dispozicion edhe për këtë rast. Në përputhje me rregullën 49 të Rregullores së punës të Panelit, e cila parasheh që çështjet që nuk trajtohen me këto rregulla të rregullohen nga Paneli, vendos se pasi të jetë përfunduar Procesi i OKB-së për kërkesat e palëve të treta, ankuesit mund të kërkojnë nga Paneli që të rihap këto procedura. Paneli pastaj do të vendosë në bazë të informatave në dispozicion, nëse mund ta pranojë një kërkesë të tillë apo jo.

PËR KËTO ARSYE,

Paneli, njëzëri,

SHPALL ANKESËN TË PAPRANUESHME.

Nedim OSMANAGIQ
Ushtrues detyre i zyrtarit ekzekutiv

Marek NOWICKI
Kryesues